



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Këshillit mësimor – shkencor të Fakultetit ekonomik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të vendimit *Nr.14-932/6* të datës 20.12.2023 të Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit ekonomik, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës, komisioni në përbërje: **1. Prof.Dr. Brikend Aziri - Kryetar, 2. Prof.Dr. Ibish Mazreku - anëtar, 3. Prof. Dr. Arun Tairi - anëtar, 4. Prof. Dr. Bardhyl Dauti - anëtar, 5. Prof. Dr. Etem Iseni - anëtar**, pasi vlerësoi disertacionin e doktoraturës me titull: “*Ndikimi i auditimit në performancën financiare të kompanive të sigurimit në Kosovë*”, të kandidatës **Mr. Sc. Yllka Ahmeti**, paraqet këtë:

RAPORT

Për vlerësim të disertacionit të doktoraturës „*Ndikimi i auditimit në performancën financiare të kompanive të sigurimit në Kosovë*“ të kandidatës Mr. Sc. Yllka Ahmeti

Këshilli mësimor shkencor i Fakultetit ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e tij të rregullt, na përcaktoi si anëtarë të komisionit për vlerësim të punimit të doktoraturës të kandidatës Mr.Sc. Yllka Ahmeti me temë: „*Ndikimi i Auditimit në performancën financiare të kompanive të sigurimit në Kosovë*” Punimi u shqyrtua me vëmendje të thellë, me qëllim që përpara Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit të dorëzojmë këtë raport.

Punimi i doktoraturës nga kandidatja Mr. Sc. Yllka Ahmeti me temën "*Ndikimi i auditimit në performancën financiare të kompanive të sigurimit në Kosovë*" është një punim i gjerë dhe thelbësor, i pasur me analiza dhe hulumtime të thelluara. Ky shkrim përfshin një gamë

të gjerë të burimeve dhe referencave nga literatura relevante, të cilat janë shfrytëzuar me kujdes dhe me metodologji të qëndrueshme në çdo kapitull të disertacionit.

Ky shkrim kapërcen aspektet kryesore të sistemit financiar dhe analizon ndikimin e tij në rritjen ekonomike. Përmes analizës së kujdesshme të tezave dhe shkrimeve të ndryshme, kandidatja ka prezantuar një përfaqje të thellë dhe të përpiktë lidhur me temën e saj. Referencat e përdorura janë burime të besueshme dhe të rëndësishme që kontribuojnë në thellimin e njohurive dhe kuptimit të sistemit financiar dhe ndikimit të tij në zhvillimin ekonomik.

Punimi paraqet një kontribut të rëndësishëm në fushën e studimeve ekonomike duke shqyrtuar dhe vlerësuar rolin e përcaktimit të saktë të matësve të performancës dhe efektivitetit të auditimit. Tregues më të mirë edhe më gjithëpërfshirës janë treguesit që marrin parasysh efektivitetin dhe rrezikun me gjithë problemet që shoqërojnë auditimin. Në këtë drejtim, auditimi i performancës financiare është një nga mënyrat kryesore përmes të cilit shfrytëzuesit e jashtëm të informacioneve “ushtrojnë kontroll” dhe depërtojnë në mënyrën se si kryhen punët dhe si arrihen rezultatet. Kandidatja ka shfaqur një kuptim të thellë të temës dhe ka paraqitur një analizë të detajuar dhe të strukturuar me kujdes nëpërmjet gjashtë kapitujve të punimit.

1. LËNDA E HULUMTIMIT

Rritja apo edhe ruajtja e një profitabiliteti konstant është ndër përgjegjësitë më të rëndësishme të menaxhmentit për të gjitha llojet e bizneseve. Për ta realizuar këtë objektiv të rëndësishëm, sot bizneset duhet patjetër të kuptojnë dinamikën e ndryshimit global të të bërit biznes si dhe mjedisin ku ato veprojnë. Në fillim të shekullit të 21, përshpejtimi në shkallën e ndryshimeve të mjedisit biznesor, duke përfshirë: shtrirjen e fuqishme të zhvillimit ekonomik, rritjen e konkurrencës, globalizimin, rëndësinë e informacionit si dhe ndryshimet në procesin e biznesit e kanë bërë auditimin shumë dinamik, më kritik dhe më të nevojshëm se kurrë më parë.

Në përgjithësi, auditimi konsiderohet si disiplinë praktike që ka të bëjë me mekanizmat e kontrollit dhe instrumentet brenda kompanive të llojeve të ndryshme. Profesionit i auditimit, trupat përcjellëse dhe kompanitë publike, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e standardeve të ndryshme, rregullave dhe praktikave në këtë fushë. Për të diskutuar rëndësinë e praktikave të auditimit, mund të jetë e dobishme t'i shikojmë ato nga një kënd tjetër, sepse

shumica e këtyre instrumenteve dhe teknikave kanë evoluar me sjelljen e ndryshme palëve të përfshira në marrjen e vendimeve biznesore. Dështimi për t'u kushtuar vëmendje të mjaftueshme themeleve teorike të auditimit jo vetëm që mund të kufizojnë perspektivat e tij, por gjithashtu mund të parandalojë zhvillimin e duhur të fushës në lidhje me ndryshimet në mjedis.

Për pjesën më të madhe të historisë së tij, auditimi ka shërbyer si një procedurë administrative e thjeshtë e përbërë kryesisht nga dokumentet e kontrollit, numërimi i pasurive dhe raportimi tek Bordi i drejtorëve, menaxherë ose auditorë të jashtëm (për auditorë të brendshëm) si dhe tek Bordi i drejtorëve (për auditorë të jashtëm). Në kohët e fundit, megjithatë, një kombinim i forcave të ndryshme kanë çuar në një revolucion të qetë të profesionit. Kompanitë duhet të tregojnë përgjegjësi në përdorimin e parave të aksionarëve dhe efikasitetin në ofrimin e shërbimeve. Ata tani kërkojnë kompetencë dhe profesionalizëm të madh nga auditimi i brendshëm dhe burimet e pakta duhet të vendosen në mënyrë më efektive për të minimizuar dhe menaxhuar risqet. Përpunimi teknologjik bën të mundur ndjekjen dhe analizimin e të dhënave në vazhdimësi duke rritur shpejtësinë duke e bërë kështu të domosdoshme që kompanitë të këshillohen mirë nga departamenti i auditimit të brendshëm.

Studimi në fjalë është realizuar në lidhje me rolin dhe rëndësinë e auditimit në ngritjen e performancës financiare të kompanive të sigurimeve në Kosovë. Më fjalë tjera, qëllimi i këtij studimi është matja e ndikimit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në ngritjen e performancës financiare të kompanive të sigurimeve të marra si rast studimor. Në këtë studim janë përfshirë të gjitha kompanitë e sigurimeve në Kosovë, përkatësisht persona përgjegjës që preken drejtpërdrejt me auditimin (bordi i drejtorëve, komiteti i auditimit, menaxhmenti dhe vetë personeli i punësuar në departamentin e auditimit).

2. KORNIZA METODOLOGJIKE

Për të arritur qëllimin e punimit, përkatësisht të zbatimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm, zbatimit të standardeve të auditimit të brendshëm, kompetencës profesionale, kontrolleve të brendshme dhe pavarësisë së auditimit të brendshëm, është kryer një anketim në kompanitë e sigurimeve në Kosovë mbi mënyrën se si perceptohet funksionimi, roli, rëndësia e auditimit në sektorin e sigurimeve, cilat janë sfidat dhe standardet që duhet të arrijë auditimi i brendshëm në të ardhmen. Grupi i synuar i këtij anketimi janë anëtarë të Bordeve të drejtorëve,

menaxherë të departamenteve, divizioneve dhe degëve që janë përballur së paku një herë me auditimin e brendshëm si dhe vetë auditorët e brendshëm.

Poashtu, si burime parësore i të dhënave, për të vlerësuar ndikimin e auditimit të jashtëm në rritjen e performancës financiare tek kompanitë e rastit studimor, janë marrë pasqyrat financiare dhe janë analizuar edhe raportet e auditimit të jashtëm si dhe zbatimi i rekomandimeve të këtyre auditorëve në funksion të rritjes së performancës së kompanive të sigurimeve në Kosovë për një periudhë kohore 2013 – 2018. Në të dhënat parësore, është bërë analiza e raporteve të publikuar të auditimit të kompanive të sigurimeve si dhe janë analizuar gjetjet dhe rekomandimet e auditorit për 12 kompanitë e sigurimeve, përkatësisht nga të gjitha kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë deri më 31 dhjetor 2018 pasi ato shfaqen në bazën e të dhënave të Bankës Qëndrore të Kosovës. Raporti i mbikëqyrjes së BQK gjithashtu siguron listën, adresën fizike dhe detajet e kontaktit të të gjitha kompanive të sigurimit në Kosovë. Në bazë të të gjitha këtyre të dhënave primare dhe sekondare, janë siguruar të dhënat për të gjitha variablat e varura dhe të pavarura, të cilat përmes regresionit të shumëfishtë të aplikuar përmes SPSS, na kanë sjellë deri të vërtetimi apo jo i hipotezave të parashturara dhe përgjigjet në pyetjet hulumtuese.

3. HIPOTEZA HULUMTUESE

Në punim janë parashtuar dhe vërtetuar hipotezat kryesore të formuluar bazuar në rishikimin e literaturës dhe modelin e aplikuar janë si vijon:

H1: Ekziston një lidhje negative në mes nivelit të leverazhit dhe performancës financiare të kompanisë së sigurimeve. Kjo hipotezë sugjeron se nëse nivelin e leverazhit është i ulët, performanca financiare e kompanisë së sigurimeve do të jetë më e ulët.

H2: Ekziston një lidhje pozitive në mes moshës (jetëgjatësisë) së kompanive të sigurimeve dhe performancës financiare. Kjo hipotezë presupozon se kompanitë e sigurimeve me një historik më të gjatë dhe më të qëndrueshëm kanë tendencë të kenë një performancë financiare më të mirë.

H3: Ekziston një lidhje pozitive në mes madhësisë së kompanive të sigurimeve dhe performancës financiare. Kjo hipotezë sugjeron se kompanitë e sigurimeve të mëdha kanë tendencë të kenë një performancë financiare më të mirë krahasuar me ato të më të voglat,

H4: Ekziston një lidhje pozitive në mes kapitalit të kompanisë dhe performancës së kompanisë së sigurimeve. Kjo hipotezë sugjeron se një kapital më i madh në dispozicion të kompanisë së sigurimeve do të ndikojë pozitivisht në performancën financiare.

H5: Ekziston një lidhje pozitive në mes aseteve të prekshme të kompanive të sigurimeve dhe performancës financiare. Kjo hipotezë presupozon se një bazë e aseteve të qëndrueshme dhe e madhe do të kontribuojë në rritjen e performancës financiare të kompanisë së sigurimeve.

H6: Ekziston një lidhje pozitive në mes likuiditetit të kompanisë dhe performancës së kompanisë së sigurimeve. Kjo hipotezë sugjeron se një nivel i lartë i likuiditetit do të përmirësojë performancën financiare të kompanisë së sigurimeve.

H7: Ekziston një lidhje pozitive në mes rritjes së kompanisë dhe performancës financiare të kompanisë së sigurimeve. Kjo hipotezë presupozon se një rritje e qëndrueshme dhe e volitshme në madhësi të kompanisë do të ndikojë pozitivisht në performancën financiare.

H8: Madhësia e firmës së auditimit (BIG4) ka efekt në performancën e kompanive të sigurimeve. Kjo hipotezë sugjeron se kompanitë e sigurimeve që përdorin firmat e auditimit të mëdha (BIG4) kanë tendencë të kenë një performancë financiare më të mirë.

H9: Ekziston një raport pozitiv në mes mandatit të kompanisë së auditimit dhe performancës së kompanisë së sigurimeve. Kjo hipotezë presupozon se një mandat i zgjatur i firmës së auditimit do të ndikojë pozitivisht në performancën financiare të kompanisë së sigurimeve.

H10: Ekziston një lidhje negative në mes rotacionit të kompanisë së auditimit dhe performancës së kompanive të sigurimeve. Kjo hipotezë sugjeron se një rotacion i lartë i firmave të auditimit do të ketë një ndikim negativ në performancën financiare të kompanisë së sigurimeve.

Për shpjegimin e të gjitha variablave është formuluar modeli ekonometrik i përgjithshëm, nga i cili janë nxjerrë 6 modele tjera që shpjegojnë dhe provojnë të vërtetojnë të gjitha hipotezat e parashtruara. Me anë të këtyre hipotezave bazë të caktuara si dhe me testimin e tyre ne arrijmë në përmbushjen e qëllimit kryesor të punimit.

4. REZULTATET E PRITSHME

Punimi “Ndikimi i auditimit në performancën financiare të kompanive të auditimit në Kosovë” do të ndihmojë në rritjen e rolit dhe imazhit të auditimit në kompanitë e sigurimeve për ta bërë atë më efektiv dhe profesional. Kjo do të ndihmojë aksionarët të vlerësojnë rolin e auditimit, sidomos atij të brendshëm, si një nga sistemet më të rëndësishëm të kontrollit menaxherial në një kompani, e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre. Hulumtimi po ashtu, do të ndihmojë në rritjen e rolit dhe imazhit të auditimit në kompanitë e sigurimeve për ta bërë atë më efektiv dhe profesional. Kjo do të ndihmojë aksionarët të vlerësojnë rolin e auditimit, sidomos atij të brendshëm, si një nga sistemet më të rëndësishëm të kontrollit menaxherial në një kompani, e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre. Hulumtimi ka marrë në konsideratë ecurinë e këtyre kompanive për periudhën 5 vjeçare. Si rezultat, janë përfshijë të gjitha kompanitë e formuara më parë dhe të formuara gjatë kësaj periudhe si dhe të dhënat primare që janë në dispozicion.

Gjetjet do të ndihmojnë studiuesin të bëjë rekomandime të kujdesshme për kompanitë e sigurimeve për të siguruar përgjegjshmëri efikase. Përveç kësaj, rezultati i studimit do t'i mundësonte atyre të zbatojnë raportin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në mënyrë që të sigurojnë efektivitetin e auditimit në përgjithësi mbi përgjegjshmërinë dhe transparencën e kompanive të sigurimeve

5. ORGANIZIMI I PUNIMIT

Ky hulumtim shkencor ka për synim të japë një pasqyrë të hollësishme në lidhje me mundësinë e ndikimit të auditimit në rritjen e performancës financiare të kompanive të sigurimeve në Kosovë duke marrë për bazë studimi një periudhë kohore së paku 5 vjeçare. Rezultatet e hulumtimit janë analizua dhe përmes tyre janë arritur objektivat e hulumtimit si:

1. Identifikimi i diferencave mes auditimit të brendshëm dhe sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mes auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm,
2. Identifikimi i rolit të auditimit të brendshëm në caktimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe rëndësinë e tij në performancën financiare të kompanive të sigurimeve,

3. Identifikimi i rolit të auditimit të brendshëm në menaxhimin dhe mbështetjen e sistemeve të menaxhimit të riskut dhe rëndësinë e tij në përshtatjen e performancës financiare të kompanive të sigurimeve,
4. Identifikimi i shkallës së pavarësisë dhe kompetencës që i jepet auditimit të brendshëm dhe rëndësinë e tij në rritjen e performancës financiare të kompanive të sigurimeve,
5. Përcaktimi i rolit dhe ndikimit të auditimit të jashtëm në performancën financiare të kompanive të sigurimeve,
6. Përcaktimi i ndikimit të pasqyrave financiare dhe shërbimeve të sigurimeve në kompanitë e sigurimeve.

Hulumtimi do t'u shërbejë të gjithë përdoruesve të informacionit kontabël, kompanive profesionale, organeve përgjegjëse në lidhje me auditimin në Kosovë dhe kompanive të huaja të interesuara në lidhje me vlerësimin e auditimit. Qëllimi i hulumtimit është për të konstatuar se në ç'masë sistemi konkret auditues ndikon në performancën financiare të kompanive të sigurimeve në Kosovë. Gjithashtu, nga hulumtimi vërtetohet se në aspektin teorik dhe praktik sistemi i auditimit nuk duhet konsideruar vetëm nga aspekti i të qenit instrument i konstatimit të gabimeve, lëshimeve dhe mashtrimeve, por edhe si nxitje në shënjestër të rritjes së performancës financiare të këtyre kompanive. Duhet pasur parasysh dhe faktin që jo të gjitha auditimet kanë ndikim pozitiv në rritjen kësaj performante. Prandaj, për të konstatuar këtë, janë parashtruar disa objektiva hulumtuese të cilat do të ndihmojnë në arritjen e pritjeve shkencore të hulumtimit si:

- Implementimi i standardeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm ka ndikim domethënës në performancën e kompanive të sigurimeve në Kosovë,
- Kompetenca profesionale, efikasiteti i punës dhe pavarësia e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm ka ndikim domethënës në performancën financiare të kompanive të sigurimeve në Kosovë,
- Krijimi i raporteve të drejta dhe fer në mes të auditorit të brendshëm dhe të jashtëm kanë ndikim domethënës në efikasitetin e auditimit si proces.

Punimi është i organizuar në 7 kapituj. Më konkretisht:

Kapitulli i parë në studim ka për qëllim prezantimin e hulumtimit dhe krijimin e një bazë të fortë për lexuesin. Këtu paraqiten elementet kyçe të studimit, duke përfshirë shtrimin e problemit, pyetjet kryesore të kërkimit dhe hipotezat bazë. Fillimi i kapitullit fokusohet në

prezantimin e hulumtimit. Përshkrimi i hulumtimit mund të përfshijë informacion mbi fushën e studimit, motivimin e hulumtimit dhe arsyetimin për zgjedhjen e temës së studimit. Pas prezantimit të hulumtimit, shtrimi i problemit paraqet pyetjen kryesore të studimit ose problematikën që synohet të zgjidhet nëpërmjet hulumtimit. Kjo pjesë qartëson nevojën dhe rëndësinë e studimit duke identifikuar një boshllëk në njohuritë ekzistuese ose një çështje që ka nevojë për zgjidhje. Pas shtrimit të problemit, prezantohen pyetjet kërkimore të studimit. Këto pyetje shërbejnë si drejtim për hulumtimin dhe synojnë të japin përgjigje konkrete në lidhje me problematikën e identifikuar. Gjithashtu, prezantohen hipotezat bazë të studimit, të cilat janë deklaramë të parashikuara që testohen nëpërmjet analizës së të dhënave. Në kapitullin e parë gjithashtu prezantohet një përmbledhje e shkurtër e metodologjisë së studimit, e po ashtu diskutohet rëndësia e hulumtimit në kontekstin e fushës së studimit dhe përqendrohet në atë se si studimi mund të kontribuojë në zhvillimin e njohurive të reja. Kapitulli i parë mbyllet me një përshkrim të strukturës së hulumtimit.

Kapitulli i dytë fokusohet në rishikimin e literaturës në lidhje me temën e studiuar. Në fillim të kapitullit, prezantohen teoritë dhe konceptet bazë të auditimit. Këtu diskutohen koncepte si pavarësia e auditimit, objektiviteti, profesionalizmi dhe transparenca. Pas prezantimit të teorive bazë, shpjegohen llojet e auditimit, duke përfshirë auditimin financiar, auditimin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm. Po ashtu, analizohet funksionimi i auditimit dhe roli i auditorëve në kryerjen e auditimit të suksesshëm. Kapitulli vazhdon me një analizë më të thelluar të roli dhe funksionit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. Përgjegjësitë e auditimit, si përcaktimi i rrezikut, planifikimi dhe zbatimi i auditimit, janë shtjelluar gjithashtu. Në vijim, kapitulli përshkruan proceset e auditimit, duke shpjeguar hapat kryesorë të kryerjes së auditimit dhe metodologjitë e përdorura. Po ashtu, analizohen marrëdhëniet midis auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe si ato kontribuojnë në përmirësimin e efikasitetit të auditimit. Një aspekt i rëndësishëm i kapitullit është analiza e auditimit si një proces që zbulon gabimet dhe mashtrimet në aktivitetet e organizatave. Kapitulli mbyllet me një rishikim të literaturës mbi kontrollin e brendshëm dhe rolin e tij në realizimin efektiv të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Kapitulli i tretë përqendrohet në historikun, zhvillimin, rolin dhe efektet e auditimit në kompanitë në Kosovë, me një fokus të veçantë në kompanitë e sigurimeve në Kosovë. Gjithashtu, në këtë kapitull analizohet roli dhe efekti i auditimit në sektorin publik në Kosovë. Fillimi i kapitullit paraqet një përmbledhje të historikut dhe zhvillimit të auditimit në Kosovë.

Kjo pjesë ofron një panoramë të zhvillimit të auditimit në vend dhe tregon ndryshimet dhe sfidat që ka përjetuar auditimi në Kosovë gjatë kohës. Një pjesë e këtij kapitulli i dedikohet roli dhe efekteve të auditimit në kompanitë e sigurimeve në Kosovë. Kapitulli po ashtu trajton rolin dhe efektet e auditimit në sektorin publik në Kosovë. Është diskutuar përdorimi i auditimit në institucionet publike për të siguruar transparencën, llogaridhënien dhe zbatimin e ligjit në shpenzimet publike si dhe konceptet dhe sistemet e matjes së performancës financiare, duke përfshirë llogaritjen e treguesve të performancës dhe analizën e tyre për të vlerësuar performancën e kompanive. Kapitulli mbyllet me një analizë të ngjashmërive dhe dallimeve në auditimin e brendshëm në Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri. Këtu është vlerësuar përdorimi i auditimit të brendshëm në këto vende dhe evidentohen ndryshimet që ekzistojnë në praktikën e auditimit të brendshëm.

Kapitulli i katërt përfshin një rishikim literature mbi sigurimet dhe auditimi në sistemin e sigurimeve në Kosovë, historiku i sigurimeve, një pasqyrë të tregut të sigurimeve në Kosovë, kornizën e kontabilitetit dhe auditimit të sigurimeve në Kosovë etj.

Kapitulli i pestë në studim përfshin disa elemente të rëndësishme të dizajnit hulumtues dhe procedurave të përdorura për të grumbulluar dhe analizuar të dhënat. Këto elemente përfshijnë: përshkrimin e dizajnit hulumtues të studimit, populacionin e synuar, Kornizën e mostrave, procedurat e grumbullimit të të dhënave dhe modelin e regresionit të shumëfishtë i cili model përfshin përcaktimin e variablave të pavarura, variablave të varura dhe mënyrën se si ato ndikojnë reciprokisht. Ky model është i rëndësishëm për analizimin statistikor të të dhënave dhe testimin e hipotezave.

Kapitulli i gjashtë në studim përmban prezentimin e gjetjeve dhe diskutimin e rezultateve të studimit të kryer, si dhe testimin e hipotezave të përcaktuara më parë. Në këtë kapitull, janë prezantuar rezultatet e analizave të kryera dhe është diskutuar se si ato ndikojnë në objektin e studimit. Kapitulli fillon me një përshkrim të përgjithshëm të objektit të studimit dhe përcakton testimet e domosdoshme për analizat e regresionit që janë kryer. Pastaj, prezantohen gjetjet dhe rezultatet e analizave. Për secilën hipotezë të caktuar më parë, analizat e regresionit është kryer duke përdorur modelin e përcaktuar në kapitullin e pestë. Rezultatet e analizave kanë treguar se si variablat e pavarura kanë ndikim në variablat e varura dhe nëse hipotezat janë të pranueshme ose jo. Diskutimi po ashtu analizon dhe interpreton rezultatet në kontekstin e objektit të studimit. Këtu vlerësohet përputhja e gjetjeve me pritshmëritë e parashikuara, ndikimi

i variablave të pavarura në variablat e varura, dhe eventuale shpjegime për rezultatet e papritura ose të pakonsekuentë.

Kapitulli i shtatë në studim përfshin përmbledhjen, përfundimet dhe rekomandimet e hulumtimit. Në këtë kapitull, janë prezantuar në mënyrë sintetike rezultatet kryesore të studimit dhe janë përfshirë vlerësimet e tyre në kontekstin e pyetjes së hulumtimit. Pjesa e përfundimeve ka prezantuar vlerësimin e përgjithshëm të rezultateve të studimit dhe përgjigjen e pyetjes së hulumtimit. Këtu janë shpjeguar nëse hipotezat kanë qenë të pranueshme ose jo dhe se si rezultatet kontribuojnë në njohuritë ekzistuese në fushën e studimit. Në fund të kapitullit, janë prezantuar rekomandimet e studimit. Këto rekomandime kanë përfshirë fushat potenciale të zgjerimit të studimit, metoda shtesë të hulumtimit që mund të zbatohen, apo sugjerime për punë të ardhshme që mund të vijnë nga rezultatet e studimit.

6. Vlerësim dhe propozim

Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës në bazë të vendimit *Nr.14-932/6* të datës 20.12.2023 nga Këshilli Mësimor Shkencor të Fakultetit Ekonomik në Universitetit të Tetovës dëshiron të njoftojë Këshillin Mësimor Shkencor me vlerësimin e tij për punimin e doktoraturës me temë "Ndikimi i auditimit në performancën financiare të kompanive të sigurimit në Kosovë" të dorëzuar nga kandidatja Mr. Sc. Yllka Ahmeti.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, komisioni arriti në përfundimin se kandidatja posedon kualitetet e nevojshme për të realizuar studime kërkimore-shkencore në fushën e shkencave ekonomike. Punimi i dorëzuar nga kandidatja shërben si model i shkëlqyer që ilustron qasjen e duhur dhe metodologjinë për kërkimet doktorale.

Bazuar në karakteristikat dhe cilësitë e paraqitura në punimin e doktoraturës dhe në cilësitë e vërtetuara të kandidatës, me kënaqësi propozojmë:

Miratimin e Raportit të punimit të doktoraturës me temën "*Ndikimi i auditimit në performancën financiare të kompanive të sigurimit në Kosovë*" të dorëzuar nga kandidatja Mr. Sc. Yllka Ahmeti.

7. Lejimin e mbrojtjes së punimit të doktoraturës nga kandidatja.

Për besimin tonë në cilësitë shkencore të kandidates dhe kontributin e vlefshëm që ajo sjell në fushën e shkencave ekonomike, shpresojmë që Këshilli Mësimor Shkencor të miratojë këtë propozim dhe të japë mundësinë për zhvillimin e procesit të mbrojtjes së punimit të doktoraturës. Kandidatja i posedon kualitetet e nevojshme për të realizuar studime kërkimore-shkencore në fushën e shkencave ekonomike, ndërsa ky punim paraqet shembullin se si duhet të jetë qasja e kandidatëve gjatë përpunimit të një punimi të doktoraturës.

Antarë të komisionit:

1. Prof. Dr. Brikend Aziri – Kryetar _____ ;
2. Prof. Dr. Ibish Mazreku - anëtar _____ ;
3. Prof. Dr. Arun Tairi- anëtar _____ ;
4. Prof. Dr. Bardhyl Dauti- anëtar _____ ;
5. Prof. Dr. Etem Iseni - anëtar _____ ;

Tetovë, Mars 2024